



Prishtinë, 02 shtator 2021
Kodi i ZRRE-së: V_1351_2021

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 9 paragrafi 1 nënparagrafi 1.7, Nenin 15 paragrafi 1 nënparagrafi 1.15, Nenin 25, Nenin 26 paragrafi 1 nënparagrafi 1.2 dhe Nenin 43 paragrafi 1 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084);
- Nenin 25 të Rregullës Nr. 11/2017 për Procedurën e Autorizimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja bazuar në Burimet e Ripërtritshme të Energjisë;
- Nenin 18, 19 dhe 20 të Rregullës Nr. 10/2017 për Skemën Mbështetëse për Gjeneratorët e BRE-ve, dhe
- Aplikacionin për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për vetë - konsum nga panelet solare/fotovoltaike, në objektin në parcelën ngastradastrave Nr. 2476/0 ZK Vitomericë, me kapacitet të instaluar prej 70 kW, e pranuar me nr. Prot. 109/21 të datës 03.02.2021 nga aplikuesi N.P.T.“SEDEFI COMERC”, me adresë: fshati “Vitomericë”, Komuna e Pejës, Republika e Kosovës,

në seancën e mbajtur më 02 shtator 2021 nxori këtë:

V E N D I M

PËR NDËRTIMIN E KAPACITETEVE GJENERUESE PËR VETË-KONSUM

- I. APROVOHET** - kërkesa e aplikuesit N.P.T.“SEDEFI COMERC”, për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për vetë – konsum nga panelet solare/fotovoltaike në objektin në parcelën ngastradastrave Nr. 2476/0 ZK Vitomericë, me kapacitet të instaluar prej 70 kW në Komunën e Pejës.
- II. OBLIGOHET** – aplikuesi N.P.T.“SEDEFI COMERC”, me shifër të regjistruar të njehsorit elektrike DPE-9055253 që pas ndërtimit të kapaciteteve të reja gjeneruese për vetë-konsum, të parashtrij kërkesë në KEDS SH.A., për pranim teknik të objektit energjetik.
- III. ZRRE do të konsideroj projektin e finalizuar nga data e pranimit teknik sipas Pëlqimit Elektroenergjetik të lëshuar nga KEDS SH.A.**
- IV. Aplikuesi N.P.T.“SEDEFI COMERC”, do të lidh Marrëveshje për vetë-prodhim me furnizuesin me të cilën ka kontratë për furnizim me energji elektrike, pas konfirmimit të pranimit teknik nga KEDS SH.A., në pajtim me nenin 18 paragrafi 1 dhe 2 i Rregullës Nr. 10/2017 për Skemën Mbështetëse.**



Arsyetim


- ZRRE, me datë 03.02.2021 nga aplikuesi N.P.T. "SEDEFI COMERC", ka pranuar aplikacionin për marrjen e vendimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për vetë – konsum nga panelet solare/fotovoltaike në objektin në parcelën ngastra kadastrave Nr. 2476/0 ZK Vitomericë, me kapacitet të instaluar prej 70 kW në Komunën e Pejës.
 - Aplikuesi, s'bashku me aplikacionin ka bashkangjitur edhe dëshminë nga KEDS për konsumin vjetor të energjisë elektrike, vlerësimin për prodhimin vjetor në kW/h të pajisjeve të instaluara, pëlqimin elektroenergetik Nr. 8149 të datës 24.08.2021 të lëshuar nga KEDS SH.A., dhe Pëlqimin Nr. 08-350-111768/20 i dt. 30.11.2020 të lëshuar nga Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit e Komunës së Pejës.
 - Bordi i ZRRE-së, pas analizimit të kërkesës së aplikuesit N.P.T. "SEDEFI COMERC", dhe dëshmimeve të bashkangjitura, për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për vetë - konsum nga panelet solare/fotovoltaike në objektin në parcelën ngastra kadastrave Nr. 2476/0 ZK Vitomericë, me kapacitet të instaluar prej 70 kW në Komunën e Pejës, ka vlerësuar ato, dhe ka konsideruar se janë plotësuar të gjitha dëshmitë relevante për lëshimin e vendimit për ndërtimin e kapaciteteve gjeneruese për vetë-konsum, dhe duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij Vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij Vendimi.
- V. Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.
- VI. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.


Vendimi iu dërgohet:

- Palës,
- Komunës së Pejës,
- KEDS SH.A.,
- KESCO dhe
- Arkivit të ZRRE-së


Bordi i ZRRE-së:


Ymer Fejzullahu, kryesues


Selman Hoti, anëtar


Izet Rushiti, anëtar


Lutfije Dervishi, anëtare


Gani Buçaj, anëtar